



One
Oricum Bay
Hotel & Residences



Ku Qetësia Takohet
Me Aventurën


Mirë se vini në One Oricum Bay

One Oricum Bay gëzon një vendndodhje gjeografike strategjike pranë porteve kryesore si ai i Vlorës, i Durrësit dhe porteve më të vogla në Himarë dhe Sarandë. Aeroporti i ardhshëm i Vlorës do të përmirësojë më tej aksesin, duke reduktuar ndjeshëm kohën e udhëtimit nga Tirana. Ky zhvillim ndodhet gjithashtu pranë një marine, që ofron shërbime jahtesh dhe lundrimi


me vela dhe përfiton nga pikëkalimet kufitare të afërta me Greqinë. Për më tepër, One Oricum Bay ndodhet shumë pranë tunelit të sapohapur të Llogarasë dhe Qafës së Llogarasë duke ofruar akses të drejtpërdrejtë në Rivierën Shqiptare, me kohë udhëtimi drejt destinacioneve të preferuara si Vlora, Dhërmiu dhe Tirana që variojnë nga 28 minuta deri në 2 orë.

Porta juaj drejt Rivierës Shqiptare

E vendosur në zemër të Rivierës Shqiptare, One Oricum Bay është e rrethuar nga një pasuri atraksionesh dhe aktivitesh. Qoftë nëse kërkon përjetime historike e kulturore, aventura emocionuese, apo thjesht relaksim në një mjedis natyror mahnitës, kjo zonë ka diçka për çdo njeri. Eksploroni rrënojat antike të Orikumit, zbuloni historinë e pasur të rajonit, ose nisuni në ekskursione emocionuese drejt qyteteve dhe fshatrave përreth. Ecni nëpër Parkun Kombëtar të Llogarasë me peizazhe mbresëlënëse, zbuloni gjire të fshehura dhe plazhe të virgjëra, ose shijoni sportet ujore në detin Jon dhe Adriatik me ujëra të kristalta. Vendndodhja strategjike e One Oricum Bay ofron akses të lehtë në një mori përvojash, duke siguruar një qëndrim të paharrueshëm si për banorët ashtu edhe për vizitorët.




Atraksione



Vlora

One Oricum Bay, i ndodhur vetëm pak minuta nga Vlora, është lehtësisht i aksesueshëm nga **Aeroporti Ndërkombëtar i Vlorës** dhe ndodhet pranë **Marina Orikum**, një nga destinacionet bregdetare më tërheqëse të zonës. Shëtitorja Lungomare në Vlorë, është një pedonale bregdetare piktoreske përgjatë Detit Adriatik, ideale për shëtitje dhe perëndime dielli, e rrethuar nga Gadishulli piktoresk i Karaburunit dhe Ishulli i Sazanit, si dhe e rreshtuar me palma, kafene dhe restorante.




Llogara

Parku Kombëtar i Llogarasë, i ndodhur në jugperëndim të Shqipërisë, është i njohur për pamjet mahnitëse malore, pyjet e dendur dhe biodiversitetin e pasur. Me një sipërfaqe mbi 1,000 hektarë, parku ofron shtigje piktoreske që kalojnë nëpër pyje të lashta me pisha dhe përfshin Qafën e famshme të Llogarasë, nga ku shfaqen pamje të mrekullueshme të Detit Jon. Është një destinacion i preferuar për alpinistët, dashamirësit e natyrës dhe aventurierët që kërkojnë një përvojë të veçantë natyrore.



Zvërnec

Zvërneci, pranë Vlorës, është i njohur për lagunën e tij të qetë dhe Ishullin e Zvërnecit, i lidhur me një urë prej druri. Vizitorët gëzojnë bukurinë e qetë të zonës, pyjet me pisha të dendura dhe Manastirin historik të Shën Marisë të shekullit të XIII, duke e kthyer këtë zonë në një vend qetësie me një bukuri të pasur kulturore.



Kalaja e Porto Palermos

Kalaja e Porto Palermos, e vendosur përgjatë bregdetit mahnitës të detit Jon, është një fortesë historike pranë Himarës. Ndërtuar në fillim të shekullit të 19-të nga Ali Pasha, ajo ofron pamje panoramike të detit dhe mure të trasha guri që pasqyrojnë të kaluarën osmane. Kalaja, e rrethuar nga ujëra të kaltër turkiz, është një vend magjepsës për entuziastët e historisë dhe udhëtarët që kërkojnë bukurinë bregdetare.



Koncepti Arkitektonik

Koncepti arkitektonik i One Oricum Bay ndërthur në mënyrë harmonike shpërndarjen organike me peisazhin përreth. Dizajni përfshin tre vëllime të lidhura me njëra-tjetrën, duke balancuar hapësirat publike me ato rezidenciale private dhe paraqet një fasadë unike me harqe që ofrojnë hije dhe interes vizual. Kati i parë, i mbuluar me gur, themelon strukturën, ndërsa bimësia e dendur krijon ndjesinë e privatësisë dhe ndarjes mes apartamenteve dhe dhomave të hotelit. Identiteti i projektit është thellësisht i rrënjosur në kontekstin historik të zonës, duke marrë frymëzim nga elementët arkitektonikë të fshatit të lashtë Tragjas, veçanërisht përdorimi i harqeve dhe gurit, që krijon një dizajn dinamik dhe me rezonancë kulturore.

Dizajni i ndërtesës karakterizohet nga një fasadë unike me harqe që ndajnë njësitë e njëkohësisht sigurojnë hije dhe nga një kat i parë i fortë me mbulim muri prej guri. Gjithashtu, bimësia luan një rol të rëndësishëm në krijimin e hapësirave rekreative dhe në ndarjen e apartamenteve nga dhomat e hotelit.

Identiteti Arkitektonik

Për të krijuar identitetin e objektit që po propozojmë, duhet të kryejmë një analizë të thellë gjeografike dhe gjithashtu kulturo-historike. Identiteti i propozimit tonë lidhet ngushtë me origjinën historike të zonës përreth, kryesisht fshatit të vjetër Tragjas. Tragjasi i Vjetër ndodhet në kodrat ngjitur me Orikumin, rreth 10 km larg sheshit që kemi në studimin tonë. Elementi i fortë arkitektonik që kemi marrë nga rrënojat e Tragjasit është pikërisht harku. Gjithashtu, për t'i dhënë objektit edhe më shumë dinamizëm, kemi përdorur materialin e gurit në katin e parë, duke krijuar një masë të fortë që mbështet tre vëllime të tjera më kompakte.






Jeta në bregdet, e imagjinuar ndryshe.

One Oricum Bay shfaq një dizajn të përsosur arkitektonik të brendshëm dhe të jashtëm, me një fasadë unike dhe të dallueshme që e veçon nga të tjerët. Ndërtuar sipas standardeve më të larta të ndërtimit dhe duke përdorur teknologjitë më të fundit, rezidencat ofrojnë një përvojë të përshtatur të brendshme me tre paketa të veçanta mobilimi dhe dekorimi, duke garantuar një ambient jetese të personalizuar dhe luksoz.

Projekti One Oricum Bay do të ndërtohet me produkte me cilësi të lartë, të përzgjedhura nga gama e produkteve të **Brunes Group**.


Materialet




Gur
Natyral



Stuko
Veneciane




Dru



Terrazzo

Materialet që janë përdorur janë materiale nga zona, ku pjesa bazë është bërë me gur, si një material i fortë dhe si një element që përdoret në këtë zonë prej mijëra vitesh. Katet e sipërme pritet të kenë një trajtim me stuko veneciane, që përveç bardhësisë së mureve u jep atyre elegancë, ndërsa materiali i ashpër krijon një nuancë të bukur në dritë/hije. Materiale të tjera që janë përdorur përfshijnë drurin, gurin terrazzo, bimët lokale dhe të tjera.



One Oricum Bay

Projekti ka një sipërfaqe totale prej

15,093.6 m²

e organizuar në

1 Hotel

me sipërfaqe totale prej 5,677.5 m²

2 Ndërtesa Rezidenciale

G1 me sipërfaqe totale prej 4,570.2 m²

G2 me sipërfaqe totale prej 4,801.2 m²

85 Apartmente Gjithsej

G1 - 42 Njësi

G2 - 43 Njësi

8 Kate i Lartë

1 Kat Nëntokë – Vendparkime

Ndërtesat Rezidenciale – 96 Poste Parkimi

Hoteli – 26 Poste Parkimi





**Përqafo Jetën
Bregdetare**
Hoteli One Oricum Bay

Rreth Hotelit

Zgjohu me pamje mahnitëse nga deti dhe relaksohu në ambiente luksoze. Përveç rezidencave luksoze, One Oricum Bay përfshin edhe një hotel të integruar me kujdes, që pasuron përvojën në tërësi. Rezidentët mund të shijojnë një pjesë të jetës së hotelit me akses në facilitetet dhe shërbimet e tij të veçanta. Spa-ja e hotelit, një vakt i shijshëm në bar-restorant ose organizimi i eventeve në sallën e konferencave – të gjitha vetëm disa hapa larg rezidencës suaj.



Siperfaqe Totale

5,677.5 m²

08

Kate Rezidenciale

60

Dhoma Hoteli

21

Njësi Duplex

26

Njësi Parkimi

Ndërtesa e hotelit do të ofrojë shërbime si pishinë, restorante, beach bar-e, spa dhe qendër fitness-i, të cilat do të jenë në dispozicion për përdorim nga rezidentët me një tarifë shtesë shërbimi. Këto facilitete do të krijojnë një standard të lartë dhe të rafinuar jetese për rezidentët dhe investorët e projektit.

Kati i parë, i mbuluar me gur, stabilizon dhe themelon strukturën, ndërsa bimësia e dendur krijon ndjesinë e privatësisë dhe ndarjes mes apartamenteve dhe dhomave të hotelit. Identiteti i projektit është thellësisht i rrënjësuar në kontekstin historik të zonës, duke marrë frymëzim nga elementët arkitektonikë të fshatit të lashtë Tragjas, veçanërisht përdorimi i harqeve dhe gurit, që kontribuon në një dizajn dinamik me rezonancë kulturore.

Materialet e përdorura janë karakteristike për këtë rajon, ku baza mbi të cilën mbështeten tre vëllimet kryesore është ndërtuar me gur – një material i qëndrueshëm dhe i përdorur në këtë territor për mijëra vjet.

Katet e sipërme do të përfundojnë me stuko veneciane, që jo vetëm i jep mureve bardhësinë karakteristike, por edhe një ndjesi shtesë elegancë; për më tepër, struktura e ashpër e materialit lejon që sipërfaqja e bardhë të marrë nuanca të bukura nën dritë dhe hije.



One Oricum Bay përfshin një hotel të integruar me kujdes, që pasuron përvojën e jetesës. Imagjinoni të relaksoheni në spa-n e hotelit, të shijoni një vakt të shijshëm në bar-restorant, ose të organizoni evente në sallën e konferencave – të gjitha vetëm disa hapa larg rezidencës suaj. Ky kombinim unik i jetesës rezidenciale dhe asaj hoteliere krijon një përvojë të vërtetë të pakrahasueshme në One Oricum Bay.





**Përfeto Jetesën
Luksoze Rezidenciale**

Rezidencat One Oricum Bay

TIPI 1

Apartament 1+1



Sipërfaqe Apartamenti	65.79 m ²
Sipërfaqe Ballkoni	19.05 m ²
Sipërfaqe e Përbashkët	8.29 m ²
Sipërfaqe Totale	93.13 m²



Apartamenti 1+1 është i organizuar me një korridor shpërndarës, një banjo, një dhomë ndenjeje me kuzhinë, një dhomë gjumi me garderobë të ndarë dhe një ballkon të bollshëm i aksesueshëm si nga dhoma e gjumit ashtu edhe nga dhoma e ndenjes.

TIPI 2

Apartament 1+1
me Verandë



Sipërfaqe Apartamenti	66.88 m ²
Sipërfaqe Ballkoni	32.32 m ²
Sipërfaqe e Përbashkët	9.69 m ²
Sipërfaqe Totale	108.89 m²
Sipërfaqe e Verandës	22 m ²



Apartamenti 1+1 me verandë është i organizuar me një korridor shpërndarës, një banjo me ventilim natyral, një dhomë ndenjeje me kuzhinë, një dhomë gjumi, një ballkon të bollshëm i aksesueshëm si nga dhoma e gjumit ashtu edhe nga dhoma e ndenjes, si dhe një verandë shumë e rehatshme për të shijuar pamjen e detit.

TIPI 3

Apartament 2+1



Sipërfaqe Apartamenti	75.27 m ²
Sipërfaqe Ballkoni	31.95 m ²
Sipërfaqe e Përbashkët	10.47 m ²
Sipërfaqe Totale	117.69 m²



Apartamenti 2+1 është i organizuar me një dhomë ndenjeje me kuzhinë, një banjo, dy dhoma gjumi dhe një ballkon të bollshëm i aksesueshëm si nga dhomat e gjumit ashtu edhe nga dhoma e ndenjes.

TIPI 4

Apartament 2+1
me Verandë




Sipërfaqe Apartamenti	74.47 m ²
Sipërfaqe Ballkoni	33.39 m ²
Sipërfaqe e Përbashkët	10.54 m ²
Sipërfaqe Totale	118.40 m²
Sipërfaqe e Verandës	24 m ²



Apartamenti 2+1 me verandë është i organizuar me një korridor shpërndarës, një banjo, një dhomë ndenjeje me kuzhinë, dy dhoma gjumi, një ballkon të bollshëm i aksesueshëm si nga dhomat e gjumit ashtu edhe nga dhoma e ndenjes, si dhe një verandë shumë e rehatshme për të shijuar pamjen e detit.

TIPI 5

Apartament 3+1
me Verandë




Sipërfaqe Apartamenti	98.52 m ²
Sipërfaqe Ballkoni	43.55 m ²
Sipërfaqe e Përbashkët	13.88 m ²
Sipërfaqe Totale	155.95 m²
Sipërfaqe e Verandës	24.20 m ²



Apartamenti 3+1 është i organizuar me një korridor shpërndarës, tre dhoma gjumi, një dhomë ndenjeje me kuzhinë, dy banjo (një me ventilim natyral), një ballkon të bollshëm i aksesueshëm si nga dhomat e gjumit ashtu edhe nga dhoma e ndenjes, dhe një verandë minimale për të shijuar natyrën.

Afati Kohor i Projektit



Përvoja & Angazhimi

Prej më shumë se 30 vitesh, Brunes Group ka ofruar një gamë zgjidhjesh për tregun e ndërtimit, duke përfshirë:

Produkte ndërtimi dhe interior design:

Dysheme dhe pllaka, pajisje sanitare, mobilie dhe elementë të tjerë dekorativë të importuar nga marka prestigjioze ndërkombëtare.

Vizion i Brunes Group është të vazhdojë transformimin e tregut të ndërtimit dhe dizajnit të brendshëm në Shqipëri, duke sjellë standarde të reja në cilësi dhe funksionalitet, dhe duke përmbushur nevojat e tregjeve lokale dhe ndërkombëtare.

Zgjidhje cilësore për projekte të mëdha & të vogla:

Nga hapësirat rezidenciale dhe komerciale deri te destinacionet turistike ekskluzive.

Me partneritete me mbi 200 marka kryesore ndërkombëtare, Brunes Group siguron që çdo projekt të përmbushë standardet më të larta dhe të shërbejë si një shembull i cilësisë dhe inovacionit.

Për më shumë detaje rreth Brunes Group dhe gamës së gjerë të produkteve dhe projekteve të saj, ju ftojmë të vizitoni www.brunes.al

Rreth Brunes Group

Brunes Group është një nga kompanitë kryesore në Shqipëri në sektorin e ndërtimit, dizajnit të brendshëm dhe produkteve të lidhura, duke kombinuar cilësinë me inovacionin dhe përvojën me vite.

E themeluar në vitin 1994, kompania ka konsoliduar një pozicion të fortë si partner strategjik në realizimin e projekteve të mëdha infrastrukturore dhe rezidenciale.

Brunes Group është një kontribues i rëndësishëm në projekte prestigjioze si Green Coast Resort, Vlora Marina dhe Casa del Lago.

Brunes u themelua në vitin 1994 si një biznes modest që shpejt njohu një zgjerim dhe zhvillim të konsiderueshëm. Sot, Brunes është lider i tregut si në Shqipëri ashtu edhe jashtë, duke ofruar një gamë të gjerë produktesh me cilësi të lartë dhe duke përmbushur në mënyrë të vazhdueshme nevojat e klientëve dhe partnerëve të saj.

Dekoll nisi në 2015 si një investim i Brunes. Është fabrika më moderne në Ballkan, falë teknologjisë më të fundit italiane të prodhimit. Kompania ka arritur sukses të madh, duke u vlerësuar jo vetëm nga klientët, por edhe nga komuniteti.

Pinto Color është një fabrikë moderne e specializuar në prodhimin e bojërave, e krijuar për të ngritur standardet e ndërtimit duke kombinuar teknologjinë inovative, cilësinë e produkteve dhe profesionalizmin.

Termax është kompania më e re dhe më moderne në Ballkan, e pajisur me teknologjinë më të fundit italiane të prodhimit, në përputhje me standardet evropiane.

Lobby Home është një qendër tregtare e sapohapur në Tiranë, me një sipërfaqe prej rreth 13,000 m². Ajo ofron gjithçka që lidhet me shtëpinë tuaj, nga materialet e ndërtimit deri te mobiliat e brendshme dhe pajisjet shtëpiake.

Brunes Construction synon të jetë kontraktori i preferuar duke ofruar shërbime ndërtimi cilësore dhe profesionale në një mjedis integriteti dhe besimi.

Brunes Real Estate është një agjenci moderne imobiliare që ofron shërbime profesionale për blerjen, shitjen dhe dhënien me qira të pronave. Ne sigurojmë zgjidhje të sigurta dhe efikase për çdo klient.





Ndërtuar nga
Brunes Construction

+355 69 601 5802
info@brunesconstruction.al